




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH, SPORTS

Departamenti i Kulturës / Departman za Kulturë / Department of Culture

Me qëllim të zhvillimit, avancimit dhe promovimit të krijimtarisë së Artit Pamor, dhe sipas Vendimit të Ministrit për Kulturë, Rinë dhe Sport z. Hajrulla Çeku me numër 23/2022 të datës 22.02.2022 për Ndarjen Çmimit Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi" dhe Çmimit Vjetor për të Arriturat në Fushën e Artit Pamor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

**KONKURS**

Për Çmimet që i ndanë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e Artit Pamor.

Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi" dhe Çmimit Vjetor për të Arriturat në fushën e Artit Pamor, që u jepen krijuesëve të dalluar, të cilët me krijimtarinë e tyre artistike kanë lënë gjurmë të thella në fushën e Artit Pamor.

**Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi".**

- Ky Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi" u ndahet personaliteteve të shquara në fushën e Artit Pamor për të Arriturat profesionale, për ngritjen e vlerave dhe për kontributin e veçantë në avancimin e Artit Pamor. Çmimi mund të jepet edhe pas vdekjes së autorit;
- Laureatë të Çmimit mund të jenë të gjithë krijuesit e fushës së Artit Pamor.

**Çmimi Vjetor për të Arriturat në Fushën e Artit Pamor**

- Çmimi Vjetor për të Arriturat në fushën e Artit Pamor u jepet krijuesëve të dalluar për të arriturat gjatë vitit paraprak;
- Çmimet u jepen shtetasëve të Republikës së Kosovës;
- Çmimi Vjetor për të Arriturat në fushën e Artit Pamor - jepet për këto gjini:
  1. pikturë
  2. skulpturë
  3. grafikë

4. qeramikë
  5. vizatim
  6. dizajn grafik
  7. fotografi artistike
  8. video art dhe art konceptual
  9. performancë
- Me vlerësimin e Jurisë Profesionale, Çmimi Vjetor për të arriturat në fushën e Artit Pamor mund t'u jepet dy krijuesëve;
  - Në raste të veçanta, kur vlerësohet se veprat nuk plotësojnë kriteret artistike – profesionale, Juria Profesionale nuk jep Çmim vjetor për kategori përkatëse;
  - Ceremonia e dhënies së Çmimeve organizohet çdo vit me 1 Qershor.

**Konkurrimi për Çmimin Kombëtar për Veprimtari Jetësore “Muslim Mulliqi” dhe Çmimit Vjetor për të Arriturat në fushën e Artit Pamor mund të bëhen përmes propozimeve nga:**

1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
  2. Galeria Kombëtare e Kosovës
  3. Fakultetet e Arteve të Universiteteve publike dhe private të Republikës së Kosovës;
  4. Asociacionet (shoqatat) profesionale të Artit Pamor
- Propozimi duhet të përmbaj: arsyetimin me shkrim, si dhe materialet e tjera përcjellëse për të nominuarin, nëse janë relevante me Çmimin përkatës;
  - Propozuesit nuk mund të bëjnë më shumë se një propozim;
  - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit njofton me shkrim Institucionet, që kanë të drejtën e nominimit, për dërgimin e nominimeve për dhënien e Çmimit dhe përcakton afatin e dorëzimit të tyre në MKRS;
  - Në raste kur nuk ka propozime nga Institucionet përkatëse, Juria Profesionale mund të propozoj afat shtesë brenda kohës së paracaktuar për dhënien e Çmimit;
  - Institucionet nominuese duhet të sjellin foton e veprës në tri (3) kopje dhe jo domosdoshmërisht CD-në me incizim, ose ndonjë material tjetër vizual dokumentues;
  - Propozimi duhet të firmoset nga titullari i institucionit/asociacionit/shoqatës që ka të drejtën e propozimit.
  - Propozimi me shkrim duhet të dërgohet jo më larg se 30 ditë nga dita e shpalljes së Konkursit në faqen zyrtare të MKRS, në Arkivin e MKRS-së, për Departamentin e Kulturës, në Zyrën nr. 022 (Adresa: MKRS, 10.000 Prishtinë, Rruga “Nëna Terezë” nr. 35).
  - Vlerësimin për ndarjen e Çmimeve e bën Juria Profesionale e përbërë nga 3 anëtarë.

**Propozimet me dokumentacion të pakompletuar nuk do të shqyrtohen.**

Prishtinë, 16.03.2023